



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument Parlamentar

Tiranë, më 11.09.2018

**RAPORT
PËR
PROJEKTLIGJIN
“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, PËR SHITESËN E DYTË TË FINANCIMIT PËR
PROJEKTIN E SIGURISË SË DIGAVE”**

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 11.09.2018, mori në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e dytë të financimit për projektin e sigurisë së digave”.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin Bledar Çuçi.

Në mbledhjet e Komisionit për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të Komisionit ishin të pranishëm zëvendësministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë znj. Dorina Çinari, përfaqësues të kësaj ministrie si dhe përfaqësues të ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Ratifikimi i kësaj marrëveshje bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kreu II “Marrëveshjet Ndërkombëtare”, neni 121 i saj.

II. QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Qëllimi i projektligjit është ratifikimi i marrëveshjes për shtesën e dytë të financimit për projektin e sigurisë së digave, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për akordimin e një financimi shtesë në vlerën 12 milionë euro, për projektin e sigurisë së digave.

Objektivat e projektit janë:

1. Rritja e sigurisë së digave të hidrocentraleve më të mëdha të sistemit elektroenergjetik shqiptar në kaskadën e lumit Drin;
2. Rritja e sigurisë dhe cilësisë së furnizimit me energji elektrike, nëpërmjet rritjes dhe përmirësimit të efikasitetit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet hidrike, duke ndikuar në këtë mënyrë edhe në rritjen e qëndrueshme të sigurisë së furnizimit me energji elektrike në tregun rajonal të energjisë.

Shtesa e dytë e financimit për projektin e sigurisë së digave, i cili përbën fazën e pestë të programit, konsiston në pjesët e mëposhtme:

- Pjesa 1: Investime në infrastrukturën e sigurisë së digave;
- Pjesa 2: Asistencë teknike dhe trajnim për sigurinë e digave.

Financimi shtesë për projektin e sigurisë së digave do të garantojë:

- a) kompletimin e të gjithë furnizimeve dhe instalimeve dhe kryerjen e të gjitha provave, vënien në punë dhe dorëzimin agregatëve/turbinave nr.1 dhe nr.4 në HEC Koman, si dhe kryerjen e të gjitha pagesave për furnizimin dhe punimet që do të kryhen nga kontraktori;
- b) financimin e gjithë aktivitetit të konsulentit të implementimit dhe panelit të ekspertëve të projektit në rolin e asistencës për PMU dhe supervisorit të kontraktorit;
- c) financimin e gjithë aktivitetit të rehabilitimit të portave të shkarkimit dhe të remontit të HEC Fierzë dhe Koman.

Zbatimi i projektit do të bëhet nga Koorporata Elektroenergjetike Shqiptare, deri më 31 dhjetor 2020. Marrëveshja e huasë parashikon që fondet e kredisë do t'i nënhyzohen KESH, sh.a.-së, me të njëjtat terma të marrëveshjes së huas, nëpërmjet një marrëveshjeje nënhyzje që do të lidhet ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe subjektit zbatues.

Marrëveshja e huasë ka një afat maturimi prej 23 vjet duke përfshirë periudhën prej 7 vitesh pa pagesë principali dhe është pjesë e parashikimeve buxhetore të Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare për periudhën 2018 – 2021.

Marrëveshja është miratuar, në parim, nga Këshilli i Ministrave, me vendimin nr.303, datë 25.5.2018, dhe është nënshkruar ndërmjet palëve. Në përputhje me nenin 121 të Kushtetutës dhe ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, marrëveshja po i paraqitet për ratifikim Kuvendit të Shqipërisë.

III. PËRFUNDIM

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

Në aspektin ligjor, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit,

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, e miratoi atë me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm dhe u shpreh dakord për kalimin për votim në seancë plenare.

RELATORI

KRYETARI

BLEDAR ÇUÇI

ULSI MANJA